

Nr. .... Prot

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_. 2022

Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Lënda: Kthim përgjigje.

**MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË,  
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLITIKAVE TË ZHVILLIMIT  
TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË,  
Adresa: Rruga “Abdi Toptani” Nr.1**

Në përgjigje suajës me Nr. 6618/1 prot., datë 20.09.2022 “Mbi kërkesën e Televizionit Ora News për informacion”, protokolluar pranë KESH-sh.a. me Nr. 4716 prot., datë 21.09.2022, ju bëjmë me dije si më poshtë vijon:

1-Duke filluar nga 1 Janari 2022, KESH-sh.a. ka blerë energji elektrike në zbatim të VKM-së Nr. 456, datë 29.06.2022 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të liçencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, ngarkon prodhuesin publik të hyjë në procedura tregtimi (blerje/import) të energjisë elektrike, me qëllim garantimin me furnizim të energjisë elektrike për klientët që përfitojnë nga shërbimi universal.

Për periudhën 1 Janar deri më 25 Shtator 2022, KESH-sh.a. ka kryer blerje të energjisë elektrike për sigurimin e plotë të kërkesës së FSHU-sh.a., në atë sasi që nuk garantohet nga rezerva energjitike e kaskadës së Drinit, konkretisht, si më poshtë:

Blerje energji elektrike sipas detyrimit per sherbim publik te vendosur me VKM 456/2022						
Shoqëria	Statusi	Sasia	Çmimi	Vlera	TVSH	Vlera me TVSH
		MWh	Euro/MWh	Euro	Euro	Euro
Janar	Blerje	137.750,00	237,23	32.677.830,40	3.579.659,54	36.257.489,94
Shkurt	Blerje	209.736,00	230,35	48.311.803,76	8.254.759,58	56.566.563,34
Mars	Blerje	165.655,00	237,90	39.408.782,65	4.460.104,63	43.868.887,28
Prill	Blerje	44.328,00	209,62	9.291.902,74	276.922,35	9.568.825,09
Maj	Blerje	76.864,00	210,57	16.184.914,86	1.625.918,77	17.810.833,63
Qershor	Blerje	117.973,00	230,84	27.233.280,11	3.898.089,43	31.131.369,54
Korrik	Blerje	170.381,00	439,19	74.829.131,66	11.657.195,26	86.486.326,92
Gusht	Blerje	120.030,00	482,32	57.892.565,98	8.412.719,96	66.305.285,94
Shtator	Blerje	125.256,00	479,23	60.026.234,30	7.722.635,02	67.748.869,32
<b>TOTALE</b>	<b>Blerje</b>	<b>1.167.973,00</b>	<b>313,24</b>	<b>365.856.446,46</b>	<b>49.888.004,54</b>	<b>415.744.451,00</b>

2-KESH-sh.a., gjithashtu, për vitin 2022, ka kryer procedura të optimizimit të portofolit ekonomik, duke iniciuar procedura blerje të energjisë elektrike në profile orare kur çmimi është më i ulët dhe shitje të sasive në profile orare ku çmimi është më i lartë. Diferenca e çmimit të shitjes me atë të blerjes, përbën për shoqërinë përfitim financiar. Konkretisht, për periudhën e mësipërme, KESH-sh.a. ka kryer transaksione të optimizimit si më poshtë:

Shit-blerje e energjisë elektrike për optimizim financiar të shoqërisë KESH sh.a.						
Shoqëria	Statusi	Sasia	Çmimi	Vlera	TVSH	Vlera me TVSH
		MWh	Euro/MWh	Euro	Euro	Euro
Janar	Shitje	840,00	338,57	284.400,00	-	284.400,00
	Blerje	-	-	-	-	-
Qershor	Shitje	1.740,00	398,24	692.931,00	138.586,20	831.517,20
	Blerje	1.740,00	291,37	506.983,20	101.396,64	608.379,84
Korrik	Shitje	3.400,00	317,19	1.078.460,00	215.692,00	1.294.152,00
	Blerje	3.400,00	281,17	955.992,70	139.636,22	1.095.628,92
Gusht	Shitje	900,00	600,91	540.821,70	108.164,34	648.986,04
	Blerje	720,00	525,69	378.495,00	75.699,00	454.194,00
Shtator	Shitje	600,00	600,91	360.547,80	72.109,56	432.657,36
	Blerje	780,00	525,85	410.160,00	82.032,00	492.192,00
TOTALE	Shitje	7.480,00	395,34	2.957.160,50	534.552,10	3.491.712,60
	Blerje	6.640,00	339,10	2.251.630,90	398.763,86	2.650.394,76
	Efekti Financiar	840,00	56,24	705.529,60	135.788,24	841.317,84

3-Në datat 1-2 Prill 2022, KESH-sh.a. u gjend në kushtet e prurjeve të mëdha në basenet e Komanit dhe të Vaut të Dejës, ku si pasojë e reshjeve intensive në këto ujëmbledhës, nivelet e liqeneve të Komanit dhe të Vaut të Dejës arritën në vlerat maksimale. Në zbatim të rregullores së plotave dhe në kushtet kur prioritet ka siguria e digave, **KESH-sh.a. kreu operacione të shitjes së energjisë në kushtet e prurjeve të mëdha**, me qëllim shmangien e derdhjes së ujit pa prodhim energjie e rrjedhimisht pa përfitim financiar, konkretisht si më poshtë:

SHITJE ENERGJI ELEKTRIKE NE KUSHTET E PRURJEVE TE MEDHA						
Muaji	Statusi	Sasia	Çmimi	Vlera	TVSH	Vlera me TVSH
		MWh	Euro/MWh	Euro	Euro	Euro
Prill	Shitje 1-2 Prill 2022	11.850,00	142,52	1.688.884,86	290.966,17	1.979.851,03
TOTALE	Shitje	11.850,00	142,52	1.688.884,86	290.966,17	1.979.851,03

Lidhur me parashikimin e importit për periudhën vijuese, duam të sqarojmë se KESH-sh.a., operacionet tregtare i ndjek në dinamikë duke analizuar:

- Së pari, kërkesën e dërguar nga shoqëria FSHU-sh.a. për furnizimin e klientëve universalë;

- Së dyti, kushtet meteorologjike, kur në rast reshjesh shiu, e gjithë kërkesa për furnizimin e klientëve universalë do të sigurohet nga prodhimi i kaskadës. Në rast se kushtet meteorologjike janë pa reshje shiu dhe me temperatura të uleta, atëherë bëhet një kombinim import dhe prodhim vendas.
- Së treti, çmimet e bursave të rajonit, duke i marrë si referencë me qëllim optimizimin e kostove të blerjes, duke blerë më shumë sasi energjie në ato periudha kur bursa ka një rënie të çmimeve dhe duke blerë pak/aspak sasi energjie në ato periudha kur çmimet në bursa janë të larta.
- Dhe së katërti, një komponent i rëndësishëm në sigurimin e energjisë elektrike është ajo e sigurimit të kapaciteteve transmetuese në ankandet e zhvilluara nga Operatorët e Sistemit të Transmetimit të shteteve përkatëse nga ku sigurohet marrja e energjisë elektrike deri në destinacionin final. Çmimet e kapaciteteve mujore për muajt Nëntor dhe Dhjetor 2022 nuk janë përcaktuar, pasi ankandet e shti-blerjes për secilin muaj hapen rreth datës 15 për muajin paraardhës.

Për rrjedhojë, për shkak të varësisë nga dinamika e kushteve meteorologjike, e çmimeve të bursave të rajonit gjatë periudhës në vijim, KESH-sh.a. gjendet në kushtet ku nuk mund të parashikojë me objektivitet vlerën dhe sasinë e energjisë elektrike që do të kontraktohet për periudhën vijuese.

Ju faleminderit,

**ADMINISTRATORI**

**Ergys VERDHO**